



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 481/4 Prot.

Tiranë, më 13.09.2022

VENDIM
Nr. 116, datë 13.09.2022

MBI PËRFUNDIMIN E HETIMIT ADMINISTRATIV, PËR VLERËSIMIN E LIGJSHMËRISË, PËR PROCEDURËN E NDJEKUR NË KOMUNIKIMIN E MASËS TËRHEQJE VËMENDJEJE, NDAJ NËNPUNËSIT *****

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, “Në lidhje me vlerësimin e zbatimit të ligjit gjatë procedurës për marrjen e masës administrative Tërheqje vëmendjeje, ndaj nëpunësit *****”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 481 datë 30.05.2022, nëpunësi civil ***** me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Agjensia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë, ka ngritur pretendimin se janë shkelur rregullat procedurale dhe dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kuadër të procedimit mbi procesin e nisjes së ecurisë disiplinore dhe heqjes së ditës së punës. Me qëllim Inspektimit e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ në institucionin Agjensia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë.

Mbështetur në informacionin e ardhur, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe titullari i institucionit, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Konstatohet se *****, është një nga nëpunësit që ka munguar në mbledhje pa ndonjë shkak të arsyeshëm, të njohur nga drejtuesi apo nga njësia e burimeve njerëzore, prandaj nëpërmjet shkresës nr. 594 Prot., datë 26.05.2022, atij i është tërhequr vëmendja për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen.

Në lidhje me mungesën e nëpunësit në fjalë në mbledhjen e zhvilluar në datën 26.05.2022 dhe për të evidentuar faktin se nëpunësi nuk ka njoftuar paraprakisht eprorin apo njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, është mbajtur procesverbali me nr. 590 Prot., (me datën e mësipërme) dhe mbi këtë bazë, në vijimësi nga drejtuesi i institucionit nëpërmjet shkresës nr. 594, datë 26.05.2022, i është tërhequr vëmendja për mospërsëritjen e situatave të ngjashme në të ardhmen.

Pretendimi i nëpunësit në fjalë, se kjo masë disiplinore është e paligjshme, pasi mungesa e tij në mbledhje është bërë pa shkak të arsyeshëm, pasi në datat 26 dhe 27.05.2022, ka qenë me raport mjekësor, i vërtetuar me raportin e paaftësisë së përkohëshme, lëshuar elektronikisht nga Qendra Shëndetësore Kashar, me numër regjistri: 3139, datë 28.05.2022, për rastin konkret nuk qëndron, pasi ai nuk ka njoftuar për këtë fakt sipas rregullave, drejtuesin e institucionit ose njësinë e burimeve njerëzore, dhe ata me të drejtë kanë reaguar duke i tërhequr vëmendjen për mungesën e pajustificuar.

Në lidhje me pretendimin tjetër se masa e dhënë është e paligjshme për faktin se një masë e tillë nuk parashikohet nga legjislacioni i shërbimit civil, Komisioneri konstaton se, tërheqja e vëmendjes në këtë rast, nuk është masë disiplinore, por është një veprim administrativ që përfshihet në masat që duhet dhe mund të marrë drejtuesi, për të rritur përgjegjshmërinë e vartësve të tij, për zbatimin e disiplinës në punë dhe plotësimin e objektivave të institucionit.

Konstatohet se drejtuesi i institucionit, nuk ka pasur për qëllim dhënien e një mase disiplinore, por tërheqjen e vëmendjes së nëpunësit për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe mospërsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 481 datë 30.05.2022, “Në lidhje me vlerësimin e zbatimit të ligjit gjatë procedurës për marrjen e masës administrative Tërheqje vëmendjeje, ndaj nëpunësit *****”, dhe meqenëse në veprimet e njësisë përgjegjëse dhe titullarit të institucionit nuk u gjetën veprime apo qëndrime të kundraligjshme, kjo çështje të arkivohet.

2. Për këtë vendim të njoftohet Agjensia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë si dhe ngarkohet për njoftimin e nëpunësit *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha